



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 299/15 Prot.

Tiranë, më 27.01 2023

VENDIM

Nr. 9 datë 27.01 2023

PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT  
ME KOLEGJIN UNIVERSITAR "LOGOS"

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', neni 3, pika 4, gërma "c" si dhe në Statutin e Universitetin të Sporteve të Tiranës neni 20, pika "s", Senati akademik në mbledhjen e tij të datës 27/01/2023,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me **KOLEGJIN UNIVERSITAR "LOGOS"**.
2. Ky vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në website zyrtar të institucionit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA





**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**

Nr. \_\_\_\_\_ prot, Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023



**KOLEGJI UNIVERSITAR "LOGOS"**

Nr. \_\_\_\_\_ prot, Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023

## **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

### **NDËRMJET**

**UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS (UST)**

**DHE**

**KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS"**

Sot në \_\_\_\_, më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022, më qëllim që, në Republikën e Shqipërisë, të nxitet dhe të zhvillohet shkenca, arti dhe sporti; të formohen specialistë të lartë dhe të përgatiten shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendeve; të ofrohen mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; të integrohet mësimdhënia me kërkimin shkencor; të nxitet bashkëpunimi dhe ndërkombëtarizimi në fushën e arsimit të lartë, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet palëve:

**Universiteti i Sporteve të Tiranës, përfaqësuar nga Rektori, Prof.Dr. Agron KASA**

dhe

**Kolegji Universitar "LOGOS", përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Ilia NINKA**

## **Neni 1 Baza Ligjore**

Kjo marrëveshje nënshkruhet në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, të miratuar me Urdhër Nr. 124 datë 29.05.2020, i ndryshuar me Urdhërin nr.25 datë 26.01.2022 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, si edhe të Statutit të Kolegjit Universitar “LOGOS”, të miratuar me Urdhërin nr.93, datë 06.03.2017 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.

## **Neni 2 Objekti**

1. Palët, për realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshjeje, shprehin gatishmërinë për të bashkëpunuar së bashku për hartimin, aplikimin dhe/ose zbatimin e projekteve të përbashkëta, si edhe për zhvillimin e çdo lloji veprimtarie apo aktiviteti tjetër të nevojshëm.

2. UST dhe Kolegji Universitar “LOGOS”, në zbatim të pikës 1, të nenit 2, të kësaj marrëveshjeje, kryesisht do të:

- a. bashkëpunojnë për hartimin dhe aplikimin në projekte kombëtare, mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare, kryesisht të financuara nga BE, për të cilat do të kërkohet përfshirja e stafit akademik, stafit drejtues dhe studentëve të palëve në zbatim të këtyre projekteve;
- b. bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, - debate, konferenca, simpoziume, workshop-e, shkolla verore dhe dimërore, në fusha të ndryshme të shkencës;
- c. bashkëpunojnë për ngritjen e komisioneve/jurive/grupeve të përbashkëta të punës për të vlerësuar standardet dhe kriteret e kërkuara për zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, etj; për dhënien e gradave dhe titujve akademikë;
- d. bashkëpunojnë për lehtësimin e procedurave të transferimit të studentëve ndërmjet universiteteve;
- e. bashkëpunojnë për lejimin e shkëmbimeve afatshkurtëra të stafit akademik/ administrativ dhe studentëve;
- f. bashkëpunojnë për shkëmbimin dhe përdorimin e literaturës shkencore dhe platformave online, etj.;
- g. bashkëpunojnë për nxitjen dhe mbështetjen e projekteve kërkimore në fushat me interes të përbashkët, etj.

3. Palët, me qëllim përmbushjen me sukses, do të diskutojnë paraprakisht mbi mënyrën dhe organizimin e veprimtarive të parashikuara në pikën 2, të nenit 2, të kësaj marrëveshjeje, si edhe të bashkëpunimeve, projekteve apo aktiviteteve të tjera të përbashkëta.

## **Neni 3 Financimi**

1. Palët, rast pas rasti do të koordinojnë për mundësimin e fondeve me qëllim që të mbulohen tërësisht ose pjesërisht shpenzimet e nevojshme, për të mundësuar zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Palët, së bashku ose veç e veç, mund të kërkojnë financime të jashtme për të mundësuar zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

#### **Neni 4**

##### **Përdorimi i informacionit dhe dokumentacionit**

1. Palët bien dakord që informacionet, dokumentet apo të dhënat, e shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi, do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit të saj.
2. Palët, përveç se për qëllimin e përcaktuar në këtë marrëveshje apo që nuk bien ndesh me të, pa aprovim paraprak me shkrim të palës tjetër, nuk mund të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhënë të njëri-tjetrit.

#### **Neni 5**

##### **Të drejtat e Pronësisë intelektuale**

Të gjitha marrëveshjet që kanë lidhje me të drejtat intelektuale aktuale dhe të ardhshme të fituara nga secila palë, si pasoje e zhvillimi të një aktiviteti të përbashkët sipas nenit 2 të kësaj marrëveshjeje, duhet të rregullohen nga një shtesë marrëveshjeje e veçantë që do t'i lidhet kësaj marrëveshjeje dhe do të jetë pjesë integrale e saj.

#### **Neni 6**

##### **Njoftimet**

1. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet që realizohen në kuadër të marrëveshjes, bëhen me shkrim dhe dërgohen në adresën e mëposhtme, ose në adresa të tjera, të përcaktuara nga palët herë pas herë. Njoftimet do të dërgohen elektronikisht, në fax, ose përmes shërbimit postar të certifikuar, ku të gjithë pagesat dhe tarifat postare parapaguhën nga pala që dërgon njoftimin me shkrim.
2. Në përgjithësi, njoftimet i drejtohen:

Për Universitetin e Sporteve të Tiranës:  
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", 1001, Tiranë  
Tel: 04 2226652  
Faqja Web: [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al)

Për Kolegjin Universitar "LOGOS":  
Adresa: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati "Komfort", (përballë Pallatit të Sportit "Asllan Rusi"), Tiranë  
Telefon + 355 42 40 5355  
Celular +355 693030277  
Faqja Web: [www.kulogos.edu.al](http://www.kulogos.edu.al)

#### **Neni 7**

##### **Ndryshimi i Memorandumit**

Të gjitha ndryshimet e kësaj marrëveshjeje, që të quhen të vlefshme, duhet të jenë me shkrim, në të kundërt konsiderohen të pavlefshme.

**Neni 8**  
**Dispozitat e fundit**

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të tij nga të dyja palët dhe është i vlefshëm për një periudhë shtatëvjeçare.
2. Palët mund të kërkojnë tërheqjen nga kjo marrëveshje në çdo kohë duke bërë një njoftim me shkrim të paktën dy muaj para, si edhe duke parashtruar arsyet e tërheqjes.
3. Palët, në rast se lindin mosmarrëveshje gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, marrin përsipër zgjidhjen e tyre me mirëkuptim.
4. Kjo marrëveshje përpilohet në 4 (katër) kopje identike në gjuhën shqipe dhe secila palë merr nga dy kopje.

**PALËT NËNSHKRUESE**

**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**

**REKTORI**

**Prof.Dr. Agron KASA**

**KOLEGJI UNIVERSITAR "LOGOS"**

**REKTORI**

**Prof. Dr. ILIA NINKA**